



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.10.2019, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 11 dhe 17 shtator 2019.
2. Seancë dëgjimore me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zonjën Besa Shahini, në lidhje me masat e marra për fillimin e vitit të ri shkollor 2019– 2020 në arsimin parauniversitar.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjuzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Almira Xhembulla, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Selami Jenishehri dhe Amra Barova.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Të ftuar:

Besa Shahini – Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Zamira Gjini - drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Gerti Janaqi - Drejtor i Përgjithshëm i ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar),

Ermelinda Durmishi - këshilltare e Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimtri – Përshëndetje!

Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së komisionit!

Përpara se të vijoj me rendin e ditës, në lidhje me procesverbalet e datave 11 dhe 17 shtator, a keni diçka për të diskutuar? Nuk ka.

Miratoohen procesverbalet.

Sot në rendin e ditës kemi seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zonjën Besa Shahini, në lidhje me masat e marra për fillimin e vitit të ri shkollor 2019- 2020 në arsimin parauniversitar.

Të ftuar kemi: zonjën Besa Shahini, ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; zonjën Zamira Gjini, drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë; zotin Gerti Janaqi, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar; zonjën Ermelinda Durmishi, këshilltare e ministres, kurse zoti Eridon Kotrri dhe zoti Fadil Duka nuk janë të pranishëm.

Mund të vazhdojmë, zonja Ministre, në lidhje me masat e marra për fillimin e vitit të ri shkollor 2019-2020 nga Ministria e Arsimit.

Besa Shahini – Faleminderit për ftesën për të marr pjesë në këtë seancë dëgjimore dhe për të gjithë interesimin që tregoni rregullisht për politikën që po zbatojmë në arsimin parauniversitar, sepse me sugjerimet tuaja, gjithmonë arrijmë të përmirësojmë cilësinë e arsimit, si në shkollat publike, ashtu edhe në shkollat e tjera!

Nuk dua të zgjatem shumë, prandaj do të bëj një prezantim të shkurtër të disa masave që kemi marrë për fillimin e vitit të ri shkollor dhe do t'ua jap fjalën Zamirës dhe Gertit që të plotësojnë pjesët ku është e nevojshme eksperiencë dhe roli që luajnë në ministri dhe në agjencinë përkatëse. Më pas, do të bëjmë edhe diskutimin me pyetjet tuaja, në mënyrë që të jemi sa më korrektë për të gjitha brengat, shqetësimet, pyetjet apo sugjerimet që ju mund të keni.

Sivjet përgatitjet për vitin shkollor kanë filluar qysh në muajt maj dhe qershor, kur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe të gjitha zyrat e tjera që i përkasin këtij dikasteri, por edhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me inspektorët, të cilët sigurojnë aspektet infrastrukturore dhe higjienosanitare, nëse përmbushen nga shkollat, kanë bërë vlerësime dhe inspektime në 1595

objekte të ndryshme dhe kanë riinspektuar edhe 168 të tjera. Kemi marrë një raport të detajuar për shkollat, ku ka nevojë të ketë ndërhyrje dhe kemi njoftuar bashkitë me kohë që të bëjnë ndërhyrjet e duhura. Ashtu siç e dini, pjesa e infrastrukturës shkollore u takon bashkive. Natyrisht është detyra jonë që ta mbikëqyrim mënyrën se si bashkitë ndërhyjnë dhe kohën kur bashkitë ndërhyjnë, që ato të jenë gati për në shtator dhe këtë kemi bërë sivjet.

Sivjet për herë të parë kemi bërë edhe inspektime të aspektit kurrikular për përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollor, ku 260 shkolla në mënyrë të rastësishme janë zgjedhur për t'u inspektuar. Paraprakisht, i kemi bërë njoftimet, kështu që shkollat nuk e kanë ditur se kur do të shkojmë për të bërë inspektimin, ndaj të gjitha janë përgatitur me kohë. Aty kemi parë edhe nëse mësuesit janë gati për fillimin e vitit të ri shkollor, e kanë të gjithë dokumentacionin gati dhe nëse tekstet shkollore janë pranë shkollave dhe gati për t'u shpërndarë te nxënësit. Kështu që sivjet 16 shtatori na ka gjetur plotësisht të gatshëm për fillimin e vitit të ri shkollor dhe kemi filluar qysh ditën e parë me mësim të plotë.

Tekstet shkollore falas është një nismë, që e kemi ndërmarrë vitin e kaluar shkollor, ku vjet tekste falas kemi dhënë për të gjithë nxënësit nga klasa e parë deri në të katërtën dhe për të gjithë nxënësit e kategorive të veçanta, siç janë nxënësit që vijnë nga familje me asistencë sociale apo ata që janë me aftësi të kufizuara, nxënësit që u përkasin pakicave të ndryshme kombëtare. Ndërsa sivjet kemi arritur ta përfshijmë edhe klasën e pestë, duke mbyllur plotësisht ciklin fillor të arsimit parauniversitar me libra falas. Ajo që kemi mësuar nga vjet dhe që kemi dëgjuar edhe sivjet, është se shumica e familjeve kanë qenë shumë mirënjohës për këtë kontribut që jemi munduar ta bëjmë për shkollimin e fëmijëve të tyre, për shkak se ka hequr një barrë financiare nga barra e përgjithshme që kanë për të edukuar fëmijët e tyre.

Gjithashtu, kemi mësuar edhe një gjë tjetër, që me përkushtimin e madh të prindërve, të mësuesve dhe të drejtuesve të shkollave një pjesë e madhe e librave janë ruajtur mjaftueshëm mirë dhe mund të ripërdoren sivjet. Të gjitha tekstet e klasave të dyta, të treta dhe të katërta, që kanë pasur mundësi të ripërdoren, i kemi futur në ripërdorim. Tekstet e klasave të para i kemi zëvendësuar plotësisht, sepse nxënësit janë të vegjël dhe kanë dëshirë të shkruajnë në to, kështu që kemi vendosur t'u japim libra plotësisht të rinj. Gjithashtu, kemi zëvendësuar të gjitha fletoret e punës. Kjo do të vijojë edhe në të ardhmen, pra do të ripërdoren të gjithë librat që janë në gjendje të mirë nga klasat e dyta e më lart, si dhe do të zëvendësohen të gjitha fletoret e punës dhe librat e klasës së parë. Unë shpresoj që, me aq sa pamë sivjet, me buxhetin që kemi, duke mos e rritur edhe shumë buxhetin, por duke ripërdorur librat nga vitet e kaluara, së shpejti do të përfshijmë klasën e gjashtë dhe të shtatë dhe pastaj klasat e tjera deri tek e nënta, siç kemi premtuar deri në vitin 2021.

Kurrikulat i kemi ndryshuar këto vitet e fundit. Përmbajtja shkollore është parë si e rëndësishme që të harmonizohet, pra të bëhet një lidhje më e mirë, jo vetëm mes lëndëve të ndryshme, por edhe mes viteve të ndryshme. Kjo është arritur në vitet 2014-2019. Këtë vit ka përfunduar procesi i ndryshimeve kurrikulare dhe kurrikula e re zbatohet në të gjitha shkollat, për të gjitha klasat. Sipas ndryshimeve kurrikulare, janë bërë edhe ndryshimet e teksteve, ku tekstet e matematikës dhe të shkencës janë marrë nga botuesit e Kembrixhit dhe janë përkthyer sipas kushteve shqiptare. Kjo ka qenë një risi dhe ka sjellë një frymë ndryshe. Nxënësit nuk frikësohen më nga kimia ose fizika, por u qasen gradualisht atyre, duke i zhvilluar ato edhe më tej. Unë jam e bindur që kjo, ashtu siç ka dhënë rezultat në të kaluarën, do të vijojë të japë rezultat edhe në vijim.

Ajo që do të bëjmë tani është që të vlerësojmë si kurrikulën, ashtu edhe tekstet shkollore dhe të bëjmë ndryshimet e nevojshme, nëse ka, sipas sugjerimeve që vijnë nga mësuesit, prindërit dhe nxënësit.

Një hap të madh kemi bërë, gjithashtu, për parashkollorin. Këtë vit e kemi mbyllur kurrikulën për parashkollorin, por edhe për moshat 3-4 vjeç dhe 4-5 vjeç. Pra, të gjithë fëmijët që janë në parashkollor sot punojnë me kurrikula të reja dhe kanë udhëzues të mjaftueshëm që të mund të zhvillojnë mësim edhe lojë me këto grupmosha.

Shqipëria zë vendin e parë në rajon për përfshirjen e fëmijëve në arsimin parashkollor. Afro 80% e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç janë të përfshirë në forma të ndryshme shkollimi. Vendi tjetër pas nesh është Mali i Zi me 56%.

Aty ku duhet të bëjmë një progres më të shpejtë është përfshirja e fëmijëve në çerdhe nga mosha 0-3 vjeç, që është përgjegjësi e bashkive, por ne po mundohemi të asistojmë bashkitë me trajnimin e edukatorëve dhe të kurrikulave.

Kemi folur në fillim të këtij viti për regjistrimet në vitin akademik 2019-2020. Kemi diskutuar edhe me parë, por mendoj se duhet të përmend këtu shkurtimisht se, sipas regjistrimeve, 480 mijë është numri i nxënësve në Republikën e Shqipërisë. Nuk përfshihen këtu të gjithë nxënësit e regjistruar në arsimin profesional, si edhe në arsimin parashkollor, sepse shifrat janë në rakordim me Ministrinë e Financave dhe bashkitë.

Ajo që dua të nënvizoj, sepse u bë edhe temë diskutimesh para një jave, është që numri i nxënësve në Shqipëri, këto vitet e fundit, ka shënuar rënie nga viti në vit, kështu që edhe këtë vit kemi një numër rreth 10 mijë nxënës më pak të regjistruar në shkollë. Kjo është një dukuri që ndodh gjithkund në Ballkanin Perëndimor, por edhe në Europën Juglindore. Kam përmendur edhe më parë se në Kosovë në vitet 2016-2018 janë regjistruar 25 mijë nxënës më pak në arsimin parauniversitar, në Serbi 32 mijë më pak, në Bosnje 34 mijë më pak dhe të njëjtat shifra

i kemi edhe nga Maqedonia dhe Kroacia. I njëjti trend rënës është shënuar edhe në kohën e qeverisjes së Partisë Demokratike. Politikat tona arsimore duhet t'i rakordojmë me realitetin në të cilin po jetojmë.

Një gjë që është shënuar si sukses në vite, është se braktisja e shkollës ka rënë në shifra minimale, si edhe kalimi i nxënësve nga arsimi 9-vjeçar në atë të mesëm është rritur në nivelin maksimal, krahasuar me vitet e mëparshme, për shembull, në vitet 2012-2013 kemi pasur 4 mijë nxënës që kanë kryer arsimin 9-vjeçar, por nuk janë regjistruar në shkollën e mesme, ndërsa sot janë 1200 nxënës që mbyllin arsimin 9-vjeçar, që nuk janë regjistruar në shkollën e mesme në vitin e parë, por mund të regjistrohen në vitet pasuese. Kjo do të thotë që politikat sociale që janë ndërmarrë në vite kanë dhënë rezultat. Arsimi i mesëm në Shqipëri nuk është i detyrueshëm, por me masat që janë marrë shumica dërrmuese e fëmijëve vazhdojnë arsimin e mesëm. Ky është një lajm shumë i mirë.

Unë dje isha për një vizitë në shkollën “Ardian Klosi” në Tiranë me drejtoreshën rajonale të UNICEF-it, për të parë programin që ata zhvillojnë për të parandaluar braktisjen e nxënësve të moshave më të vogla. Në fillim të çdo viti të ri shkollor secili nxënës regjistrohet me detaje të gjendjes së tyre social-ekonomike, në mënyrë që mësuesit dhe drejtuesit e shkollave, psikologu dhe stafi tjetër që mbështet shkollën, të mund të intervenojnë nëse ka elemente që mund t'i çojnë nxënësit drejt braktisjes së shkollës. Intervenimi i hershëm është i domosdoshëm në këtë rast, e bëjmë në shumicën e shkollave, tashmë, por modelin që pamë tek “Ardian Klosi” do ta zbatojmë në të gjitha shkollat, në mënyrën sa më të shpejtë të mundshme.

Do të doja të përmendja edhe 3 gjëra të fundit, para se t'ua jap fjalën Zamirës dhe Gertit. Demokratizimi i shkollave është një aktivitet që ne e kemi marrë me shumë seriozitet. Në të gjitha shkollat bëhen zgjedhje për kryetarët e shkollave, që zëri i nxënësve të dëgjohet në instancat më të larta tek udhëheqësit e shkollës, kjo ndodh zakonisht në muajt shtator-tetor.

Ajo që kemi sjellë si risi këtë vit është që kryetarët e shkollave do të zgjedhin përfaqësuesit e tyre për parlamentin e nxënësve, që do të jetë një institucion këshillimor pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ku ne do t'i testojmë nismat tona me nxënësit, por edhe do të dëgjojmë propozimet e tyre për t'i zbatuar nëpër shkolla.

Parlamenti i nxënësve do të përfaqësohet edhe nga nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nga minoritete të ndryshme gjuhësore, kështu që do të kemi një përfaqësim më të mirë të zërit të tyre edhe tek instancat më të larta politikëbërëse.

Shpresoj shumë që edhe ju, si deputetë, do të na bashkëngjiteni në aktivitetet që do të zbatojmë me parlamentin e nxënësve dhe mendoj se do të kemi shumë për të mësuar prej jush

lidhur me mënyrën se si punoni ju në parlament, që ata të kuptojnë se si duhet t'i ndërtojnë rregulloret e brendshme të funksionimit dhe si të çojnë para idetë e tyre më të mira.

Është një projekt që kemi filluar ta zbatojmë vjet me *British Council*, i cili sivjet do të zgjerohet në shumë shkolla. Është projekti i shkollave të shekullit 21, ku ne u mësojmë të gjithë fëmijëve nga klasa e 6 – 9 kodimin përmes disa pajisjeve të vogla që quhen “Mikro bit”, që janë pajisje kompjuterike, por më lehtë të programueshme sesa të tjerat. Nxënësit po mësojnë të kodojnë dhe unë besoj se është diçka shumë e rëndësishme, sepse po arrijmë që me infrastrukturën që kemi sot, t'u mësojmë nxënësve aftësitë digjitale dhe ICT-së, të cilat do t'u duhen jo vetëm për studimet në shkollë, por edhe për jetën në të ardhmen. Të gjithë nxënësit e klasave të gjashta dhe të nënta do të kenë mundësinë të marrin pjesë te ky projekt i kodimit dhe deri në vitin 2021 do të mbyllim këtë projekt me të gjitha shkollat.

Vjet, gjithashtu, nisi edhe projekti “Oficerët e Sigurisë”, persona që qëndrojnë pranë shkollave të ndihmojnë në mbarëvajtjen e disiplinës dhe sigurisë në shkolla. Oficeri i sigurisë është një person që ka mbaruar *bachelor* ose master në një degë, si: sociologji, drejtësi, mësuesi e të tjera dhe që, më pas, ka marrë një certifikatë trajnimi nga Akademia e Sigurisë për të parandaluar ngjarje të ndryshme që mund të cenojnë sigurinë në shkolla.

Sot që flasim janë 150 oficerë sigurie nëpër shkolla dhe numri i tyre do të rritet, natyrisht. Këta kanë ofruar shërbimin e tyre për 63 mijë nxënës, që janë përfitues të projektit për “Oficerët e Sigurisë”. Do të marrim mendimet e tyre gjatë muajve të ardhshëm, që të shohim se si mund ta zgjerojmë këtë nismë, por edhe duke i trajnuar këta oficerë që të përmbushin në mënyrën më të mirë të mundshme detyrat e tyre.

E fundit, në sistem sot kemi 930 mësues ndihmës. Dua të përmend paraardhësen time, zonjën Lindita Nikolla, e cila falë një vendimi kurajoz që mori në vitin 2014, mundësoi të vendosen mësues ndihmës pranë shkollave ku ka fëmijë me aftësi të kufizuara, në mënyrë që fëmijët të arrijnë potencialin e tyre maksimal brenda sistemit arsimor.

Sivjet do të shtojmë edhe një numër prej 60 mësuesish ndihmës, pra do të arrijmë në shifrën 1 mijë mësues ndihmës. Kemi rreth 4 mijë e 400 fëmijë me aftësi të kufizuara në sistem, pra statistikisht kemi një mësues për 4 ose 5 fëmijë, por jemi të vetëdijshëm që numri i këtyre mësuesve duhet të vijojë të rritet, sepse në një shkollë ku janë 4 fëmijë me aftësi të kufizuara në klasa të ndryshme, mësuesi jo gjithmonë arrin të qëndrojë gjithë ditën me ta, kështu që do të vijojmë të zbatojmë hapat që janë vendosur edhe për vitet në vijim.

Zamira do të flasë për Shkollën e Drejtorëve, që fillon funksionimin sivjet dhe Gerti do të flasë për të gjitha trajnimet e mësuesve që po bëhen në arsimin parauniversitar, duke

përfshirë edhe mësuesit ndihmës, si dhe përgatitjen e të gjithë stafit për një vit të suksesshëm akademik.

Faleminderit!

Zamira Gjini – Përshëndetje!

Në fakt, Shkolla e Drejtorëve ka filluar një vit më parë, ku u implementua edhe në ligjin për arsimin parauniversitar, me ndryshimet e këtij ligji në korrik të vitit 2018. Me krijimin e kësaj shkolle, një nga detyrat kryesore të Ministrisë së Arsimit ka qenë vlerësimi i nevojave të të gjithë drejtuesve, drejtorë dhe nëndrejtorë, në institucionet arsimore në të gjithë Shqipërinë.

Për këtë u ngrit një grup pune me ekspertë të huaj dhe ekspertë të fakulteteve të edukimit, Ministrisë së Arsimit dhe Institutit të Zhvillimit dhe përcaktuam ose pamë se cilat janë nevojat që kanë drejtorët për t'u trajnuar, një studim, i cili përfundoi me një raport ku janë përcaktuar pikërisht orientimet kryesore se si do të hartohet programi i zhvillimit profesional i trajnimit të drejtuesve të shkollave, që do të marrin pjesë në këtë shkollë që ne e quajmë Shkolla e Drejtorëve.

Sipas ligjit “Për arsimin parauniversitar”, pas dy vjetësh pasi ky ndryshim i ligjit nr. 48/2018 hyn në fuqi, të gjithë drejtorët e institucioneve arsimore duhet të jenë të certifikuar, duhet të kenë marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara nga Shkolla e Drejtorëve dhe duhet të marrin certifikatën që i njih ata për të ushtruar detyrën e tyre si drejtues i një institucioni arsimor.

Për ta kryer këtë proces, sigurisht, janë hedhur shumë hapa. Pas studimit dhe daljes së raportit të nevojave, Shkolla e Drejtorëve, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, ka hartuar standardet e drejtorit të shkollës, një dokument, i cili u shërben jo vetëm drejtuesve të shkollave për t'i ndihmuar se si duhet të zhvillohen nga ana profesionale, por edhe Ministrinë e Arsimit për të hartuar politikat, edhe njësitë arsimore përgjegjëse për arsimin për të zhvilluar rrjetet profesionale të drejtorëve apo trajnimet në bazë zyrash arsimore, edhe Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë për të bërë programet e trajnimit dhe vetë Shkollën e Drejtorëve për të hartuar programin e trajnimit dhe të zhvillimit profesional të të gjithë atyre që do të marrin pjesë në Shkollën e Drejtorëve. Kështu, me të gjitha këto dokumente që janë përgatitur, në nëntor të këtij viti do të fillojë Shkolla e Drejtorëve me një grup të parë prej rreth 48 personash, të cilët do të jenë edhe drejtues që janë në detyrë, por edhe persona që janë aspirantë për t'u bërë drejtorë shkollash.

Realizimi i këtij procesi, pra i pjesëmarrjes së personave në Shkollën e Drejtorëve, por edhe certifikimi i drejtorëve, pasi e kryejnë këtë trajnim, është një proces që ne, si Ministri e Arsimit, e kemi pasur në vizion dy ose tre vjet më parë që ta bëjmë, për të arritur ose për të

ngritur një sistem që në emërimin e një drejtori ose një nëndrejtori shkolle të kemi persona të zhvilluar nga ana profesionale, të aftë për ta kryer detyrën dhe të certifikuar.

Në fund të pjesëmarrjes së të gjithë personave në Shkollën e Drejtorëve, ne do të kemi një listë të të gjithë drejtuesve ose të atyre personave që do të jenë kontingjentë për të ushtruar detyrën e drejtorit apo të nëndrejtorit të shkollës.

Trajnimet që do të zhvillojë Shkolla e Drejtorëve do të kryhen në bashkëpunim edhe me Fakultetet e Edukimit dhe me Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës, pasi atje ka ekspertë që merren me këtë fushë. Trajnimet do të jenë të programuara dhe do të zhvillohen pas procesit mësimor, të zhvilluara jo vetëm nga trajnerë të Fakulteteve të Edukimit, por edhe nga ekspertë të huaj.

Këtë vit do të kemi kontingjentin e parë, ndërsa vitin e ardhshëm do të kemi më shumë pjesëmarrës në Shkollën e Drejtorëve.

Gerti Janaqi – Faleminderit!

Do të përpiqem t'i përmbledh shkurtimisht përgatitjet që ne po bëjmë për zhvillimin profesional të mësuesve. Pra, edhe këtë vit akademik është investuar shumë në zhvillimin profesional të mësuesve, por ky është një vit i veçantë, siç e theksoi edhe ministrja, pasi përfundon shtrirja e kurrikulës në sistem. Kjo do të thotë që nga mosha 3 vjeç deri në 18 vjeç në të gjithë sistemin mësimor programet dhe tekstet janë të reja.

Një fokus më i veçantë, që shkon tashmë drejt një qasjeje të re, ka të bëjë me trajnimin e mësuesve. Vetë riorganizimi i drejtorive rajonale dhe zyrave arsimore ka një benefit të jashtëzakonshëm, sepse shërbimin e shtrin deri në nivel bashkie. Vlen këtu të theksohet se kemi një drejtori arsimit universitar, katër drejtori rajonale dhe 51 zyra arsimore, të cilat në strukturat e tyre kanë njerëz që merren me zhvillimin e kurrikulës dhe trajnimin e mësuesve, por, sigurisht, në ato zyra, që kanë edhe një numër më të madh punonjësish, është rritur edhe numri i inspektorëve të arsimit. Kjo do të thotë se fokusi për të monitoruar jo vetëm cilësinë e zhvillimit profesional, por edhe procesin mësimdhënës është më i madh. Deri vitin e kaluar raporti i njerëzve që merreshin me inspektimin, ishte 20 për të gjithë sistemin, që nuk arrinin dot ta inspektonin; sot kemi rreth 150 njerëz që janë të përfshirë. Këta njerëz janë trajnuar intensivisht gjatë gjithë periudhës së verës, nga qershori deri në shtator, dhe, tashmë, janë në kapacitet të plotë për t'u përfshirë jo vetëm në monitorimin e zhvillimit profesional të mësuesve, por edhe për inspektimet që ministrja i përmendi pak më parë. Sigurisht, është një proces ku do të investohet në një afat rreth 2 vjet, mendojmë ne, si specialistë, për t'i forcuar këto kapacitete dhe për t'i integruar më pas edhe këta në trajnimin e mësuesve.

Për t'u rikthyer te zhvillimi profesional i mësuesve, ne e kemi filluar digjitalizimin e sistemit të zhvillimit profesional që para dy vjetësh dhe sot kemi një platformë *online*, ku universitetet publike dhe private apo agjencitë serioze, që ofrojnë trajnimin e mësuesve, çdo rekord të tyre e kanë *online*, duke na dhënë ne mundësi dhe akses për t'i monitoruar dhe për të parë se çfarë lloj shërbimi ofrojnë.

Është lajm i mirë që kemi rreth 16 universitete publike që ofrojnë shërbim dhe trajnim për mësuesit e arsimit parauniversitar. Jemi në një bashkëpunim edhe me universitete europiane për një projekt që lidhet me zhvillimin profesional, që është një nga projektet më të mira të Erasmus-it që Ministria e Arsimit menaxhon, ku kemi eksperiencë nga universitetet spanjolle dhe finlandeze. Për herë të parë, bashkë me kolegët ndërkombëtarë, po e shpërndajmë këtë lloj eksperience jo vetëm në Shqipëri, por po përhapim edhe imazhin pozitiv të Shqipërisë në Komisionin Europian.

Nëse do të krahasonim investimet në trajnimin e mësuesve, rreth 80% e buxhetit që investohet për trajnimin e mësuesve, trajnohen relativisht 12 deri 13 mësues çdo vit, janë fonde të buxhetit të shtetit, gjë që do të thotë se mësuesit nuk paguajnë për trajnimet e tyre, por e marrin trajnimin falas. Ndërkohë që 20% e investimit shkon përsëri nga donatorët, që janë të gjithë organizmat e UN-it, të cilët rakordojnë nëpërmjet një plani në çdo fillim viti me Ministrinë e Arsimit dhe prekin më pas çdo element, që unë do të vijoj ta shpjegoj më vonë. Në këtë kontekst, investimet kryesore përkrijnë me prioritetet dhe ruajtjen e imazhit të pikave pozitive që ka Shqipëria krahasuar me vendet e tjera.

U përmend mësuesi ndihmës. Sot ne kemi 930 mësues ndihmës. Impakti ka qenë i menjëhershëm, ndonëse qasja është e vështirë edhe në Europë për mësuesit ndihmës. Prindërit kanë një lloj solidariteti në përfshirjen e mësuesve ndihmës në sistem, pra *feedback*-u ka qenë i jashtëzakonshëm edhe për avantazhet që marrin mësuesit. Kemi një lajm të mirë që edhe universitetet që prodhojnë, po themi, specialistë si mësues ndihmës, janë duke hapur programe masteri, në mënyrë që ta furnizojnë tregun me njerëz profesionistë. Përmend këtu Fakultetin e Shkencave Sociale, i cili ka master për Pedagogjinë e Specializuar dhe, po ashtu, Universiteti i Elbasanit dhe ai i Vlorës. Pra, është një trend dhe, në bashkëpunim me arsimin e lartë, po perfeksionohet edhe më shumë metodologjia e trajtimit të mësuesve ndihmës.

Rrjetet profesionale të mësuesve janë niveli i dytë i mënyrës se si organizohet trajnimi i mësuesve. Dikur, për shembull, për ata që janë marrë me arsimin para viteve '90, quheshin "formatorë", njerëz që formonin mësuesit e tjerë. Edhe kjo ka qenë një praktikë e konsoliduar në vitin 2014 dhe sot numri i drejtuesve të rrjeteve profesionale është rreth 1040, gjë që do të thotë se këtyre mësuesve, me udhëzim ministri, iu është lehtësuar norma mësimore dhe të gjithë

ketë lehtësim e shkarkojnë në trajnimin e kolegëve të tyre brenda qytetit ku ato jetojnë sipas çdo profili.

Relativisht një drejtues rrjeti trajnon rreth 20-25 mësues. Kjo është një eksperiencë shumë pozitive, e cila po përhapet me shumë shpejtësi. Mjafton të shikoni edhe *online*. Vetë forumet e mësuesve ne po i shtyjme drejt përhapjes së kësaj eksperiencë edhe *online*, madje ka një plan të dedikuar vjetor për trajnimin e mësuesve ndihmës.

Për t'u rikthyer përsëri te një element thelbësor, tek investimi në trajnimin e mësuesve në çështje shumë specifike, sot e gjithë Europa flet për investimin në shkencë, në teknologji, në lëndët anglisht dhe matematikë. Kjo do të jetë e ardhmja e njëzet vjetëve të fundit. Pra, parashikohet që pas njëzet vjetësh, 50% e vendeve të punës në një treg global, ku po përfshijmë edhe Shqipërinë, do të ketë nevojë për aftësi të shkencave, teknologjisë, anglishtes dhe matematikës.

Pikërisht për këtë jemi përpjekur që bashkë me mësuesit, bashkë me rrjetin ndihmës dhe donatorët të investojmë në këto fusha prioritare. Ky është edhe nocioni ose risia e këtij fillim viti, madje do të jetë një program i dedikuar edhe për dy-tre vjetët e ardhshëm: do të trajnohen specifikisht 2800 mësues që ka sot Republika e Shqipërisë në sistem për shkencat e natyrës, flas për mësuesit e biologjisë, kimisë dhe të matematikës. Nga ana tjetër, kemi projektin e *British Council*, i cili prek të gjithë Shqipërinë në harkun e dy vjetëve dhe është një projekt që qeveria britanike e investon në të gjithë Ballkanin Perëndimor, por fokusi në Shqipëri ka qenë i suksesshëm, sepse është në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe prek të gjitha shkollat.

Me gjuhët e huaja, ku anglishtja ka një fokus të veçantë, kemi një bashkëpunim të jashtëzakonshëm me ekspertë që vijnë nga ambasada amerikane, ambasada britanike dhe ky është ndër rrjetet edhe më të konsoliduara. Edhe rrjeti i gjuhës shqipe, por, sigurisht, edhe matematika ka qenë një nga rrjetet e mësuesve më avangardë, sepse edhe rezultatet që ne marrim zakonisht në testet ndërkombëtare për fëmijët në matematikë janë të larta, me bashkëpunim shumë pozitiv me Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe të gjithë kolegët e universiteteve të tjera, të cilët kanë qenë pjesë e programeve dhe hartimit të teksteve.

Edhe për sa i përket parashkollorit do të kemi një risi, besoj, në dy vjetët që vijnë, duke qenë se është përmbyllur paketa kurrikulare e parashkollorit, e moshës 3-6 vjeç, ku një fokus të veçantë do të ketë trajnimi i të gjithë edukatorëve në bashkëpunim me bashkitë, sepse, siç të gjithë ju e dini, ato që menaxhojnë burimet njerëzore të sistemit parashkollor janë bashkitë, por ka ardhur momenti që në dy vjetët e ardhshëm të investohet në rreth 4 deri në 5 000 njerëz që punojnë në sistemin 3-6, për t'i trajnuar me metodologjitë më të fundit.

Të njëjtën gjë jemi duke bërë me Bashkinë e Tiranës për çështjen e standardit 0-3 vjeç për çerdhet. Në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës është ngritur një grup pune, i cili do të hartojë me ekspertizë ndërkombëtare standardet e moshës 0-3 dhe do të investohet përsëri në trajnimin e njerëzve, në mënyrë që i gjithë cikli i trajnimit dhe i zhvillimit profesional, nga çerdhja deri në shkollat e mesme, të ketë të njëjtën logjikë dhe metodologji.

Për sa u përket oficerëve të sigurisë, numri i të cilëve është rreth 150, ka qenë një nga eksperiencat më të suksesshme. Ka një rakordim shumë të mirë edhe me Ministrinë e Brendshme, pasi trajnimi i vazhduar i tyre bëhet në Akademinë e Sigurisë, sepse edhe paketa didaktike e materialeve që u ofrohet, është hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit. Edhe mënyra se si oficerët e sigurisë koordinojnë punën, ecën në dy nivele: ata raportojnë edhe në zyrat arsimore, në drejtorinë e shkollës, edhe në komisariatet e policisë, duke prodhuar në kohë reale raporte mbi numrin e incidenteve dhe të rasteve.

Këtë vit jemi duke avancuar me trajnime më specifike për ta, duke iu ofruar forma alternative të një raportimi më të thjeshtë dhe më të shpejtë. Ky është një nga projektet, që besoj se është përqaftuar edhe nga komuniteti dhe nga prindërit.

Këto ishin përmbledhtazi pikat që lidheshin me zhvillimin profesional të mësuesve.

Fatjona Dhimitri – Ndonjë nga të ftuarit e tjerë, dëshiron të shtojë diçka lidhur me masat?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, vijojmë me pyetjet dhe diskutimet nga anëtarët e komisionit.

Zonja Ministre, në dokumentin që ju keni dërguar pranë shërbimeve të komisionit tonë, theksohet se numri i nxënësve të regjistruar në arsimin parauniversitar në të gjitha ciklet është 475 000. A mund të kemi një indikator të saktë të numrit të nxënësve të regjistruar në arsimin parauniversitar, ndërkohë që në dokument thuhet se janë 475 000, në deklaratat tuaja thoni se janë 500 000, ndërsa Kryeministri uron 455 000 nxënës? Cili është numri i saktë?

Besa Shahini – Të jap përgjigje menjëherë, apo të presim të marrim të gjitha pyetjet? Si e keni organizuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Në fakt, kam disa pyetje unë fillimisht. Besoj se në vijim do të kenë edhe anëtarët e tjerë të komisionit, kështu që po vijojmë me pyetje-përgjigje.

Besa Shahini – Shumë mirë.

Shumë shkurt, ajo së cilës iu referua Kryeministri...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Gjithsesi, nëse mundeni t'i mbani shënim të gjitha pyetjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

Po vijoj me pyetjen time të dytë.

Zonja Ministre, në një nga deklaratat tuaja keni theksuar: “Në 15, 10 apo 7 nxënës në total kemi një rënie të vazhdueshme të nxënësve dhe do të ishte papërgjegjshmëri shumë e madhe financiare nga ana jonë që të investojmë në ato shkolla ku së shpejti nuk do të ketë asnjë nxënës”. Cila është përgjigjja e kësaj deklarate të bërë nga ju? Ndoshta ky është një plan juaj antikombëtar për shpopullimin e popullsisë? Si mendoni?

Si e justifikoni faktin e braktisjes së shumë shkollave nga nxënësit dhe mbylljen e shkollave në qytetet: Tiranë, Berat, Vlorë, Shkodër, Bulqizë, Mat, Pogradec dhe Elbasan?

Si e justifikoni krijimin e klasave kolektive me mbylljen e shkollave, për shkak të braktisjes së tyre nga nxënësit? Kuptohet që shumë nxënës, për shkak të varfërisë së madhe të familjeve të tyre, gjenden në kushtet e pamundësisë për të vazhduar shkollën. Disa familje të tjera janë larguar nga Shqipëria.

Vijojmë me pyetje të tjera. Ju thatë që numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën vitet e fundit është në rënie. Në fakt, nga të dhënat e INSTAT-it nuk më rezulton kështu. Si mendoni për numrin e analfabetëve, që rezulton në rritje?

Çdo fillim viti shkollor, në takimin e parë me prindër, këtyre të fundit u kërkohet dhënia e një kontributi prej 1 000 lekësh të rinj. Edhe pse ju reklamoni sistemin arsimor falas, çdo prindi u vjen mesazhi për dorëzimin e këtij kontributi. A është në dijeni MASR-ja për këtë kontribut? Për familjet me të ardhura kjo mund të jetë normale, por për ato familje që mezi i sigurojnë të ardhurat, ky kontribut është tejet i rënduar. E theksoj, ju reklamoni: “Arsimi juaj është falas”, madje theksoni që tekstet janë në përdorim falas dhe sërish e deklaruar që tekstet janë mjaft të riparuar për t’u ripërdorur nga nxënësit. Si mendoni ju? Ky riciklim i teksteve nga njëra klasë te tjetra po i bën fëmijët kopjacë dhe, sado të fshihen tekstet, cilido prind e sheh se lexohen lehtësisht fjalët e shkruara nga fëmijët e tjerë.

Lidhur me punonjësit e shërbimit psiko-social në shkolla, cili është numri aktual i tyre?

Një problem tjetër i evidentuar ka të bëjë me dhunën dhe bullizmin në shkolla. A mendoni ju, zonja Ministre, se Komisioni i Etikës në shkollë është struktura e duhur ku fëmijët mund të raportojnë rastet e dhunës, të abuzimit apo të bullizmit në shkollë? Nuk flasim këtu vetëm për dhunën ndërmjet nxënësve, por kemi edhe raste të dhunës së mësuesit ndaj nxënësve.

Milva Ekonomi – Mund ta marr pak fjalën për procedurë, zonja kryetare?

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni!

Milva Ekonomi – Në fakt, tema për të cilën e kemi thirrur ministren sot ka të bëjë me fillimin e vitit të ri shkollor në arsimin parauniversitar.

Për pyetjet që lidhen me disa nga çështjet që ju ngritët, dua t'ju sqaroj që në këtë komision janë bërë dëgjesa, ndaj nuk është momenti të bëjmë disa pyetje që kërkojnë dëgjese specifike. Ndoshta pyetjet duhen grupuar në atë mënyrë, që të kenë lidhje me temën, për të cilën është thirrur sot zonja ministre.

Fatjona Dhimitri – Nuk mendoj se isha jashtë rendit të ditës lidhur me shqetësimet e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar.

Milva Ekonomi – Por është dëgjese tjetër, se e kemi bërë një herë bullizmin, në raportin që bën ministria çdo vit.

Fatjona Dhimitri – Zonja Ministre, ju thatë që keni investuar në infrastrukturën shkollore, por në shumë godina në mjaft qytete të vendit infrastruktura shkollore është e rrënuar. Folët për laboratorë, biblioteka dhe TIK. Si mendoni lidhur me investimin e tyre? Sa është investuar për laboratorët, TIK-un dhe bibliotekat në shkolla?

Gjithashtu, ne kemi pasur një dëgjese me Shoqatën e Botuesve Shqiptarë, ku është kërkuar edhe prania juaj, ndërkohë që ju nuk ishit. Si mendoni ju lidhur me pasurimin e bibliotekës në shkolla? Shoqatës së Botuesve i rezulton se nuk e keni vlerësuar siç duhet pasurimin e bibliotekës në shkolla: në vitin 2017 nuk është bërë asnjë furnizim, në vitin 2018 janë shpenzuar vetëm 2 milionë lekë, duke mos u përdorur 18 milionë të tjerë të parashikuar në buxhet, ndërsa për 3 vjetët e fundit, pra për periudhën 2019-2021, janë parashikuar 10 milionë lekë, por ky proces lë shumë për të dëshiruar. Si e justifikoni ju këtë fakt?

Përse rrjeti i librarive është shumë i dobët? Ky është një nga shqetësimet e ngritura nga Shoqata e Botuesve dhe është një pyetje që do t'ia adresoj vetë ministres, meqenëse ministren e kemi të pranishme. Besoj se zonja Ministre do të mundohet të japë një përgjigje.

Po, urdhëroni, zonja Ministre!

Milva Ekonomi – Prisni, një herë, se do të bëjmë edhe pyetje të tjera.

Fatjona Dhimitri – Në qoftë se...

Besa Shahini – Unë do të preferoja, në fakt, t'u përgjigjesha disa prej pyetjeve që m'u parashtruan deri tani, për të vijuar me pyetje të tjera. Kështu do të ishte shumë mirë.

Po filloj nga pyetja e parë lidhur me numrin e nxënësve. Siç e thashë, shifrat që kemi sot janë operative. Në Shqipëri çdo vit prindërit marrin pak kohë derisa të regjistrojnë fëmijët. Edhe pse regjistrimet janë kryer me kohë, derisa i marrim ne të dhënat në ministri dhe pastaj derisa t'i rakordojmë me institucionet e tjera që mbikëqyrin institucionet e arsimit

parauniversitar... Kopshtet dhe çerdhet janë të bashkive, ndërsa arsimi profesional mbulohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Shifrat që ka raportuar Kryeministri, janë të dhënat operative për vitin 2019-2020, pa përfshirë numrin e nxënësve në arsimin profesional, që na vjen nga Ministria e Financave dhe deri në atë moment ne nuk i kemi pasur.

Qëndron kjo që po them, se numri operativ sot, që nuk është ende final, për shkak se duhet ta rakordojmë edhe një herë me të gjitha bashkitë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, është 480 000. Nuk kemi thënë asnjëherë se janë 500 000. Kështu që nuk e di se nga ka ardhur ajo shifër.

Për sa i përket mbylljes së shkollave dhe braktisjes, edhe një herë dua të nënvizoj se as INSTAT-i, as edhe një institucion tjetër nuk raporton rritje të braktisjes së shkollave. Kjo thjesht nuk qëndron. Ka mundësi të jetë bërë ndonjë keqlexim i të dhënave.

Me braktisje të shkollës nënkuptohen rastet kur dikush, që është regjistruar në shkollë, e ka lënë shkollën ose kur dikush, që është i moshës shkollore, nuk shkon në shkollë. Kjo nuk ndodh më në Shqipëri në përmasat që ka qenë më parë.

Siç e thashë, tërheqja nga arsimi i detyrueshëm në arsimin e mesëm është shumë i madh, aq sa sot kemi rreth 1 000 nxënës që nuk regjistrohen, në krahasim me më përpara që kanë qenë 3 000, 4 000, 5 000. Synojmë që ta çojmë në zero këtë numër, mirëpo kemi bërë progres të mjaftueshëm me të gjitha politikat dhe elementet sociale që t'i përfshijmë grupet më vulnerabël në shkolla dhe të mos shkojmë deri te braktisja e shkollimit edhe nga familje, të cilat janë në gjendje të vështirë socio-ekonomike apo që kanë probleme të tjera.

Për sa u përket klasave kolektive që mbyllen nëpër zona rurale, projekt ky që vazhdon dhe është për të mirën e fëmijëve që shkojnë në shkollë, kjo bëhet për shkak të rënies së numrit të nxënësve në zonat rurale, duke lëvizur në zonat urbane. Pra, nëse familjet kalojnë nga një fshat në qytet, mbetet një numër shumë i vogël i nxënësve për të shkuar në shkollë në fshat. Kësisoj, nuk mund të krijohen klasa të mirëfillta. Nëse, për shembull, kemi një grup prej dhjetë fëmijësh nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, ata nuk do të marrin arsim cilësor nëse grupohen të gjithë në një klasë.

Ajo që kemi bërë, me shumë përpjekje, dhe ia kemi dalë edhe vitin e kaluar, edhe sivjet, është që sa më shumë nga këta nxënës t'i kalojmë te shkollat, ku ata mund të mësojnë me bashkëmoshatarët e tyre dhe ku mund ta kenë mësuesin e anglishtes vërtet mësues të anglishtes, si dhe të mund t'i kenë të gjitha lëndët të ligjëruara nga mësues që vërtet e kanë certifikatën për atë lëndë. Pra, jo të grupohen edhe nxënësit dhe mësuesit, ashtu siç bëhet në klasat kolektive të përmendura, të cilat ne jo vetëm po përpiqemi, por do ta çojmë deri në fund projektin për t'i

reduktuar në masën më të madhe të mundshme. Paralelisht me këtë, për mësuesit që punojnë ende në klasa kolektive, aty ku ka qenë e pamundur të bëhej reduktimi i klasave kolektive, sepse ka zona shumë të thella dhe nxënësit e kanë të vështirë të transferohen në shkolla të mëdha, kemi bërë trajnime të njëpasnjëshme bashkë me ASCAP-in, kemi çuar edhe mjete didaktike, në mënyrë që mësuesit të jenë sa më të gatshëm për ta organizuar një klasë me grupmosha të ndryshme brenda së njëjtës klasë. Unë besoj se kjo ka sjellë një përmirësim dhe këtë e dimë nga testet e ndryshme që bëjnë për lexim-shkrim të nxënësve, që janë nëpër klasa kolektive.

Ju përmendët bibliotekat, botuesit dhe rrjetet e librarive. Në fakt, rrjetet e librarive nuk kanë të bëjnë fare me Ministrinë e Arsimit. Kjo e fundit ka një buxhet për furnizimin e bibliotekave shkollore. Shpresoj që botuesit ta kenë nënvizuar edhe këtu, se vitin e kaluar, kur kemi filluar procesin e furnizimit të bibliotekave shkollore, ata nuk kanë paraqitur të drejtën e autorit për një sërë librash, të cilët ne kishim nevojë t'i blinim dhe t'i kishim pranë shkollave. Sivjet ata janë përpjekur më fort dhe e kanë marrë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në mënyrë që ne të kemi mundësi të furnizojmë bibliotekat shkollore me libra artistikë që u nevojiten, qoftë edhe për mësimin e Gjuhë-Letërsisë apo edhe lëndëve të tjera. Pra, unë jam e lumtur që botuesit më në fund kanë filluar nga përpjekjet e tyre, në mënyrë që të kualifikohen për të arritur t'i shesin librat e tyre nëpër bibliotekat shkollore.

Nuk e di nëse harrova ndonjë pyetje.

Numri i punonjësve të stafit psikosocial nëpër shkolla është vazhdimisht në rritje. Sot që flasim e kemi 470 dhe do të shkojë në 560 gjatë këtij viti akademik, duke vijuar ta rrisim numrin e psikologëve dhe të punonjësve socialë nëpër shkolla, paralelisht me numrin e mësuesve ndihmës.

Kam përshtypjen se këto ishin të gjitha pyetjet.

Fatjona Dhimitri – Kishte një pyetje lidhur me laboratorët...

Besa Shahini – Më falni, ishte edhe një pyetje për tekstet shkollore!

Fatjona Dhimitri – Po.

Besa Shahini – Përdorimi i librave dhe ripërdorimi i tyre është praktikë që nuk e kemi zbuluar ne, përkundrazi, zbatohet në të gjitha shtetet e zhvilluara me sistem arsimor edhe më të zhvilluar sesa Shqipëria.

Teksti shkollor është një tekst, i cili, realisht, nuk përdoret përtej vitit që nxënësi mëson me të. Kështu që është një praktikë shumë e mirë që të ripërdoret vitin e ardhshëm.

Në shumicën dërrmuese të rasteve, në 83% të rasteve, librat janë kthyer në një formë të ripërdorshme, ku është fshirë çdo gjë e shkruar në to dhe kanë qenë plotësisht në rregull për t'u

përdorur prapë. Ndaj, ne do të vijojmë që të zbatojmë këtë praktikë, duke u kujdesur për librat që kemi dhe duke i ripërdorur deri në një gjendje të ripërdorshme.

Fatjona Dhimitri- Zonja Ministre, lidhur me laboratorët në fushën e teknologjisë dhe informacionit, sa është numri i laboratorëve të rinj që janë krijuar këtë vit? A keni ndonjë informacion për këtë?

Besa Shahini – Unë kam informacion, por një informacion të saktë do t’jua sjellim me shkrim në momentin e parë të mundshëm.

Fatjona Dhimitri- A ka pyetje nga anëtarët e komisionit?

Po, urdhëroni zoti Ismet!

Ismet Beqiraj – Përshëndetje të gjithëve!

Zonja Ministre, ju falënderoj për prezantimin e materialit shumë shterues të shumë problemeve dhe shumë pyetjeve që ne bëjmë!

Në radhë të parë dua të shpreh kënaqësinë që në këtë vit shkollor ka dy risi bazë për arsimin parauniversitar, në konceptin tim.

Risia e parë, e cila ndodh për herë të parë, është që në të gjithë sistemimin parauniversitar po zbatohet kurrikula e re, ku përfundimisht u fut edhe për klasën pestë.

Risia e dytë, nuk është gënjeshtër, por është realitet i prekshëm, është premtimi i kësaj maxhorance në fillim të këtij mandati për tekstet falas. Sivjet u dhanë falas edhe tekstet e klasës së pestë dhe, sipas shifrave, janë 225 mijë që përfitojnë, ku 125 mijë fëmijë janë të klasave 1-5 dhe 70 mijë janë, besoj, sepse nuk ishin në material, duhet të jenë nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë. Pra, duke i përfshirë këta në 16 kategori të ndryshme që përfitojnë. Kjo është një nga risitë shumë të rëndësishme që është bërë realitet.

Shoh që edhe në disa drejtime të tjera ka një trend rritjeje, edhe përtej parashikimeve të programit të qeverisë, por edhe të ministrisë, për shembull, për mësuesit ndihmës. Kujtoj para dy vjetësh, në vitin 2017, na dukeshin shifra lumturie kur numri i mësuesve ndihmës ishte 360, ndërsa sot të duket si e pabesueshme që numri i tyre shkon në 930. Edhe ky është një produkt pozitiv, që duhet vlerësuar jo vetëm për punën, por edhe për vëmendjen dhe kujdesin. Në programin “Shkolla të sigurt”, vitin e parë të pilotimit të këtij projekti, oficerët e sigurisë ishin në 15 gjimnaze dhe brenda dy vjetësh ata ishin në 115 shkolla me 138 oficerë sigurie. Nuk po ndalem tek investimet dhe te shërbimi psikosocial që është futur në shkolla.

Kam disa pyetje. Një problem shqetësues, që ka qenë ndër vite i pranishëm dhe që është edhe këtë vit, lidhur edhe me kushtet e trendit të rritjes të shkollave qendër komunitare, është mbyllja e shkollave edhe me më pak se 10 nxënës, ku edhe në zonën time elektorale kishim dy shkolla të mbyllura sivjet. Është rishikuar vendimi i qeverisë nr. 692, i vitit 2015, i cili ka të

bëjë me tarifat e transportit, sepse ky shërbim u është deleguar organeve të vetëqeverisjes vendore, por sigurisht që tregu privat i transportit nuk të afrohet me një biletë me 48 lekë të rinj. Edhe vjet e morëm këtë premtim, por deri tani nuk është bërë gjë. Ndoshta e keni të draftuar ndryshimin e vendimit, por të bëhet një kërkesë për këtë.

Pyetja tjetër. Kohët e fundit u aplikua portali “Mësues për Shqipërinë” edhe për mësuesit zëvendësues ose me kontratë, por, kryesisht, mësuesit zëvendësues janë për lëndën e edukimit fizik, mësues fizkulture. A do të zgjidhet ky ngërç, që çdo vit mësuesi i biologjisë do të bëjë edhe lëndën e edukimit fizik? Ky nuk është numër i vogël, pasi në zonën time janë gati 20 shkolla, ku duhen mësuesit e edukimit fizik, me kontrata provizore, të cilët vijnë me portal. Prandaj ky problem duhet zgjidhur.

Nga informacioni që ju jepni, shoh shumë investime. Për një periudhë 3-4 vjeçare ka gati 276 investime në infrastrukturë dhe kjo duhet përgëzuar, por dua të di kurrikulën, e cila ka për bazë laboratorët dhe qendrat eksperimentale, ku nxënësi duhet të zbatojë atë që ka mësuar, a e keni parashikuar në investime? Unë ju falënderoj për dy investimet që keni bërë në Mallakastër dhe uroj që edhe në vitin e ardhshëm buxhetor të parashikohet edhe shkolla, që është qendër komunitare, 9-vjeçare “Gjokë Doçi” në zonën e Fratarit.

Duke parë edhe shënimet e një viti më parë, ku zonja Nikolla foli për një nismë të re që do të merrte Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, për procesin e mentorimit të procesit mësimor të mësuesve nga mësuesit në pension, a e keni filluar apo e keni ndër mend ta filloni, sepse është me shumë interes?

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri- A ka pyetje të tjera?

Po, urdhëroni!

Vilma Bello- Në radhë të parë dua të falënderoj znj. Ministre për të gjithë prezantimin e plotë të situatës për masat e marra për vitin shkollor 2019-2020!

Jam shumë dakord me të gjitha risitë që përmendi kolegu im, zoti Ismet, të cilat janë edhe në materialin e paraqitur.

Për të mos humbur shumë kohë kam dy mendime dhe dy pyetje.

Pranë drejtorive të arsimit do të fillojnë punën inspektorët e arsimit. Kur do të nisin punën këta inspektorë? Në zonën time, edhe nga diskutimet e vazhdueshme me ta, shpeshherë kam dëgjuar një skepticizëm të mjaft mësuesve të duhur, me vlera të duhura, për t’u përfshirë si inspektorë pranë drejtorive të arsimit ose zyrave të arsimit. Ndonëse kjo është një pyetje që, në fakt, do të bëhet gjatë diskutimit që do të bëjmë për buxhetin, por dua të them se ata bëhen

shpeshherë skeptikë për hir të pagesës si inspektorë pranë zyrave të arsimit dhe kjo nuk i motivon për t'i nxitur dhe për të filluar si inspektorë në këto zyra.

Gjatë zhvillimit të procedurave të lëvizjeve dhe pas udhëzimit nr. 13, sa mësues kanë mbetur jashtë sistemit ose çfarë është bërë me ata mësues që kanë dalë jashtë sistemit në vlerësimin dhe në procedurat e lëvizjes që kanë zhvilluar gjatë këtij viti?

Kam një pyetje edhe për zonjën Zamira lidhur me atë që na informuat për shkollën e drejtorëve, për trajnimin dhe për nevojat e veçanta që do të këtë. Në muajin dhjetor ju thatë se do të nisë shkolla e drejtorëve dhe do të marrin pjesë drejtorë ekzistues apo edhe aspirantë. Pyetja ime është: sa është bërë vlerësimi real i drejtorëve ekzistues, sepse ka jo pak raste kur drejtorët aktualë, në gjykimin e komunitetit, të prindërve apo dhe tonin, pra të vëzhguesve, qoftë edhe si deputetë, nuk janë të duhurit për t'u përfshirë në këtë proces?

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri- Po, urdhëroni, zoti Nasufi.

Fadil Nasufi- Faleminderit, zonja Ministre!

Edhe unë u bashkohem konsideratave, por mbi të gjitha të vërtetave që kanë ndodhur në këto 6 vjet në reformën në arsimin parauniversitar dhe për produktin që po fillon të japë frytet e veta në ndryshimin cilësor të arsimit, kjo e ngjizur edhe me një ndërgjegjësim të publikut, që po i rikthehet dashurisë dhe kontributit për një arsim të shëndetshëm në të gjitha ciklet në arsim.

Nga raportimet që u bënë, për të dalë te pyetjet, ka disa praktika, të cilat janë në formën e deklarimeve statistikore, ndërkohë që ne duam produktin real. Për shembull, kur bëhen 1595 inspektime ose riinspektime nga Instituti Shtetëror i Shëndetit, a ka penalitete, ndëshkime, adresime të atyre që nuk i përmbushin detyrimet ligjore për standardin e shkollave, duke filluar që nga çerdhet dhe deri te shkollat, te klasa e dymbëdhjetë e arsimit bazë? Sepse në shumë raste marrja e masave të plota, qoftë për garancinë, qoftë për masat ligjore higjieno-sanitare, qoftë për të gjithë funksionalitetin që duhet të ketë shkolla, varet nga përgjegjshmëria dhe afeksioni që ka drejtuesi vendor.

Lidhur me librat falas, që është një ndryshim thelbësor, ku është viti i dytë që po i shtohet dhe klasa e pestë, a ka edhe bashki që po shpërndajnë libra falas ose po japin bonuse për arsimin? Vitin e kaluar kishim Fierin. Kjo është detyrë e përbashkët, jo vetëm e ministrisë dhe e qeverisë.

Lidhur me investimet publike, janë 71 projekte në arsimin parauniversitar. A keni një listë se si është shpërndarja në të gjitha territoret e bashkive? Unë dua të përshëndes standardin, me të cilat po ndërtohen shkollat e shekullit XXI. Edhe nga pikëpamja arkitekturore, estetike,

funkionale, edhe nga pikëpamja e të gjithë misionit që kryen shkolla, ato janë tamam godina. Shkolla duhet të jetë e saktë dhe me standarde, që të konkurrojë edhe tregun e ndërtimeve private, sepse shkolla është e shenjtë dhe është objekt që i bën nder qytetit apo komunitetit, nuk është thjesht një vend ku hyjnë e dalin nxënësit dhe mësuesit. Kështu që unë e përshëndes këtë dhe dua që edhe në Berat të kemi shkolla të tilla, siç janë përruar në qytete të tjera apo siç ishim në Fier me komisionin, ku pamë disa shkolla model në këtë fushë. Në raport me këtë, a kemi një inventar për gjendjen e godinave shkollore, që janë në rrezik dhe në emergjencë për investime, sipas bashkive, sepse buxheti ka hapësirën e vet të mbulimit, por rastet nuk presin vit pas viti që të gjendet zgjidhja?

Ka një trend në rritje të klasave kolektive në zonat e braktisura. Ju thoni që kryesisht bëhen trajnime për mësuesit, që japin mësim në klasa të bashkuara, po në shkollat pedagogjike ose në shkollat që nxjerrin mësues, a duhet të përgatisim në plane afatgjata mësues të veçantë, që të japin mësim për nxënësin e klasës së parë, për klasën e dytë, klasën e tretë, klasën e katërt apo vetëm çfarë na bie dhe të detyrohemi ta zgjidhim me këto forma, që ne na i diktojnë rrethanat dhe lëvizjet demografike që kanë ndodhur?

Shërbimi psikosocial, siç e thatë edhe ju, nga vit në vit shënon trend rritës në mbulimin me punonjës, por ne duhet të shqetësohemi për profilaksinë e problemeve sociale dhe psikologjinë që ndodh në këtë kategori, duke filluar nga ndikimi i rrjeteve digjitale, i drogës e të tjera, të cilat e infektojnë dhe ne nuk i shmangemi dot. Aq sa e gjejmë kurimin nëpërmjet shtimit të trupave, duhet të kemi edhe profilaksinë e mosndotjes apo mosndodhjes së fenomene të tilla.

Edhe zoti Ismet e përmendi problemin e mësuesve në moshë të madhe, që është diskutuar edhe kur ishte ministre zonja Nikolla, që duhet të reduktohen orët e tyre. Reduktimi i mësuesve krijon dy avantazhe, edhe lehtësimin e tyre në aspektin e mbingarkesës që kanë, por edhe hapjen e vendeve të punës për trupën e re pedagogjike që dalin vit pas viti dhe integrohen në mësimdhënie.

Faleminderit!

Fidel Ylli – Është bërë si rregull që në këtë komision ne dalim gjithmonë nga axhenda e miratuar në kalendar. Në rend dite kemi seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, zonjën Besa Shahini, në lidhje me masat e marra për fillimin e vitit të ri shkollor. Ne e dimë që arsimi parauniversitar ka shumë probleme dhe mund ta thërrasim ministren në një ditë tjetër, sepse ajo ka qenë e gatshme të na japë shpjegime për ato pyetje që ne kemi, por të mos shfrytëzojmë momentin dhe le ta pyesim se çfarë dëmsh ka bërë tërmeti në shkollat në Durrës, në Tiranë dhe në vendet e tjera dhe problematikat e fillimi të vitit të ri shkollor, mbledhje, e

cila mund të mbarojë për një orë, mbaron për tri orë. Më duket sikur s'jemi eficientë fare në punën tonë, sepse na merr rutina e pyetjeve. Ministrja mund të vijë prapë.

Fatjona Dhimitri - Zoti Fidel, po bëhen shumë pyetje, por nuk po na jepen përgjigje shteruese në këtë komision. Ne e pyesim ministren për laboratorë, ajo nuk përgjigjet; ne e pyesim për godina të rikonstruktura, ajo për...

Fidel Ylli – Nuk jeni ju ajo që vendosni si përgjigjet ministrja.

Fatjona Dhimitri- Problem shqetësues është bullizmi...

Fidel Ylli- E kemi thirrur për bullizmin.

Fatjona Dhimitri- Atëherë, të përgjigjet!

Fidel Ylli- Ajo po përgjigjet, por nuk je as ti dhe as unë që të japim përgjigjen e saktë, sepse është ajo që jep përgjigjet që kërkon ti dhe unë. Ministrja po u përgjigjet në mënyrë shteruese të gjitha pyetjeve tona në mënyrën e vet.

Fatjona Dhimitri- Sot ka ende shkolla me turne dhe zonja ministre s'po na përgjigjet për këto shkolla në kryeqytet apo në qytete të tjera.

Almira Xhembulla- Faleminderit, kryetare!

Dua të falënderoj ministren për prezantimin shterues, por edhe për angazhimin në sigurimin e mbarëvajtjes së fillimit të procesit mësimor, ku u uroj shumë mbarësi këtë vit të gjithë ministrisë dhe stafit.

Ndërkohë, pa u zgjatur, duke marrë shkas edhe nga fjala e kryetares, dua të filloj fjalën time me një falënderim për 4 kryetarët e qarkut, të bashkive respektive në Dibër, për mënyrën se si kanë koordinuar me zyrat vendore dhe për angazhimin që treguan, me aq mundësi sa kanë, brenda buxheteve të tyre, për të bërë rregullimet e nevojshme për një fillim sa më normal të procesit mësimor.

Në qytetin e Peshkopisë e kemi shmangur mësimin me dy turne. Të gjithë nxënësit zhvillojnë mësim vetëm në një turn dhe kjo është për t'u përgëzuar. Për këtë dua të falënderoj edhe ministren për gatishmërinë për ta shtyrë përpara këtë proces!

Problemi i vetëm, që edhe ne e hasëm, duke qenë se ishim prezentë në fillimvitin shkollor dhe në kontakte të vazhdueshme me stafin akademik, është rritja e numrit të oficerëve të sigurisë. Mendoj se duhet të shtohet numri i oficerëve të sigurisë, veçanërisht në shkollat e mesme, sidomos ato larg qytetit. Kjo ishte një kërkesë e ngritur me zë të lartë edhe nga drejtoritë, edhe nga mësuesit.

Numri i mësuesve ndihmës është në rritje, por duhet të shihet mundësia, siç u përmend edhe nga kolegja Bello, që për të gjithë mësuesit, të cilët dalin nga sistemi për shkak të shumë

kritereve dhe janë realisht profesionistë, të gjendet një mekanizëm që t'i risjellim në sistem, sepse janë disa vlera që ne nuk mund t'i humbim.

Një kërkesë shumë specifike kam për një shkollë në qytetin e Peshkopisë, e cila ka qenë shkollë muzike dhe ka profesorë që mund të japin disa lëndë muzike atje. Të gjendet mundësia për një donacion për këtë, sepse për një qytet dhe vend si Dibra do të ishte me interes të fusnim piano ose violinë, pasi mungojnë totalisht. E di që mund të duket luks që po e kërkoj këtë, por, nëse ju jepet mundësia për një hapësirë, do të ishte me interes që të paktën të ketë një klasë muzike. Sigurisht që kemi shumë problematika të tjera, siç e tha edhe kolegu Ylli, të cilat do t'i diskutojmë edhe gjatë vitit.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri- Përpara se të marrë fjalën ministrja, a ka pyetje të tjera?

Adelina Rista- Faleminderit, zonja ministre për paraqitjen tuaj për fillimin e vitit të ri mësimor!

Faktikisht, dita e parë e shkollës ka të bëjë me koordinimin e të gjithë pushtetit qendror me pushtetin vendor për të vënë në eficiencë të plotë të gjithë infrastrukturën që është në funksion të fillimit të mbarë të viti të ri mësimor. Pushteti ka detyra për bërjen gati të godinave shkollore, për higjienizimin e tyre, krijimin e kushteve të përshtatshme në bazë të standardeve, qoftë për mjediset jashtë shkollës dhe oborreve të shkollave, qoftë brenda klasave. Gjithashtu, drejtoritë arsimore, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit, janë në dispozicion për vënien e infrastrukturës për fillimin e mbarë të vitit të ri mësimor, duke filluar nga regjistrimi i nxënësve, numri i nxënësve për klasa, ndarja e klasave në bazë të mësuesve, ndarja e klasave kujdestare, pajisja me tekste mësimore e nxënësve dhe mbulimi i çdo mësuesi me normën përkatëse mësimore, të cilat përbëjnë marrjen e masave për fillim të mbarë të vitit të ri mësimor.

A u pajisën të gjithë nxënësit me tekste? A kemi mangësi nëpër shkolla për tekste?! Jo. A përfituan falas një numër i konsiderueshëm nxënësish nga vendimi i qeverisë, qoftë edhe nga vendimi tjetër për kategoritë përfituese?! Po, përfituan një numër i madh nxënësish. A kemi klasa të pambuluara me mësues?! Jo. A kemi shkolla të pafilluara dhe të pahapura për shkak të kushteve të këqija?! Jo. Pra, të gjitha këto tregojnë që viti mësimor ka filluar mbarë. Shkollat kanë qenë në gatishmëri dhe në ditën e parë të shkollës u hapën dyert për të gjithë fëmijët në Republikën e Shqipërisë në arsimin parauniversitar. A ishte edhe për nxënësin me aftësi të kufizuara mësuesi ndihmës në ditën e parë të shkollës?! Po. Dita e parë e shkollës është për të gjithë, edhe për ata me aftësi të kufizuara. Ju përgëzoj sinqerisht për infrastrukturën mësimore në ditën e parë të shkollës, sepse pushteti vendor me të ardhurat e veta ka dhënë ndihmesën e vet në rikonstruksionin e shkollave, ashtu si me fondet e qeverisë, ku shumë shkolla u

përfunduan dhe ditën e parë të shkollës i hapën dyert. Kjo ishte në të gjitha qarqet. Vetëm në qarkun e Fierit hapën dyert në ditën e parë të shkollës 2 shkolla në Lushnjë, 2 në Divjakë, 1 në Patos dhe 1 në Mallakastër. Domethënë, kishte shumë shkolla të reja, të cilat përfunduan për fillimin e vitit të ri mësimor. Po kështu, hapën dyert edhe shumë shkolla që u rikonstruktuan nga të ardhurat e bashkive. Pra, fillimi i vitit mësimor ishte i mbarë.

Unë dua të them diçka për mësuesin ndihmës. Shumë nxënës nuk e kishin mësuesin ndihmës në ditën e parë të shkollës. Dje isha në zonë dhe një nxënësi i vinte mësuesja në datën 20. Kjo mbase është në shtesat tuaja, te numri 60, për mësuesit ndihmës, këtë nuk e di.

Por edhe diçka tjetër, nga prindërit pati një reaksion për ndërrimin e mësuesve ndihmës. Dihet që nxënësi me aftësi të kufizuara ka vështirësi sa të vendosë kontaktin me mësuesin e tij ditët e para të shkollës, sa ta njohë, sa të mësohet dhe sa të mësohet edhe mësuesi me nxënësin, kalon njëfarë kohe. Kur ai mësohet, nuk do të ndahet më prej tij. Por kur ia ndërron mësuesin ndihmës në vitin e ri mësimor, te ky fëmijë ke sjell probleme, sjell probleme në familjen e tij, por edhe te mësuesi, i cili ka krijuar një lidhje me këtë nxënës. Në udhëzim thuhej: “Mësuesit ndihmës të merren nga portali”, jam dakord që të merret nga portali ai që fillon për herë të parë, por jo të hiqet ai që ka qenë në vazhdimësi në punë dhe të ndërrohet një tjetër, që nuk ia ka idenë këtij fëmije dhe se si është punuar me të e të tjerë. Ky ishte një lloj reaksioni të paktën nga prindërit në disa shkolla të qytetit tim për ndërrimin e mësuesve ndihmës. Shumë mesazhe më kanë ardhur nga prindërit ku shkruajnë: “Përse na i krijoni këto probleme, duke i ndërruar mësuesin ndihmës në momentin që fëmija im mezi u mësua me të?”

Qyteti i Fierit është shumë arsimdashës dhe ka shumë shkolla jo vetëm publike me plot nxënës, por ka edhe një numër të konsiderueshëm me shkolla jopublike, me një numër të konsiderueshëm fëmijësh, është arsimdashës për të vazhduar nga shkolla e mesme në arsimin e lartë dhe ka nxënës cilësorë, që kanë nderuar veten, familjen, arsimin dhe qytetin e tyre.

Faktikisht, Fieri nuk ka universitet, por furnizon universitetet e tjera në Republikë. Në këtë qytet ka qenë një universitet, Universiteti i Sporteve, i cili ka nxjerrë disa mësues fizikulture, të cilët kanë marrë masterin në universitetet e tjera shtetërore dhe licencën e mësuesisë. Por problemi është se çfarë ka ndodhur me këta mësues? Disa vazhdojnë të punojnë dhe e mbrojnë vendin e punës me eksperiencën 20-vjeçare, ndërsa të tjerët që kanë 15 apo 17 vjet, hiqen nga puna, sepse ai universitet 3-vjeçar nuk njihet, pavarësisht masterit që kanë bërë në Tiranë dhe licencës së mësuesit për të ushtruar profesionin. Drejtoria Arsimore ka kërkuar një interpretim për këta mësues se si do të veprohet, por akoma nuk ka marrë një përgjigje. Unë kam komunikuar me drejtoreshën rajonale pardje dhe më tha: “Kemi kërkuar një interpretim nga Ministria e Arsimit, nuk e di kur është kërkuar ky interpretim, por nuk kemi marrë një

përgjigje për këta mësues”. Këta mësues kërkojnë një përgjigje, sepse disa punojnë, ndërsa të tjerë jo. Pra, ata që kanë eksperiencë 20-vjeçare e mbrojnë vendin e punës, ndërsa të tjerë me 17-vjet janë hequr nga vendi i punës, sepse nuk e mbrojnë dot.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – A ka pyetje të tjera nga anëtarët e komisionit?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shumë pyetje u morën në shënim, të shohim përgjigjet.

Urdhëroni!

Besa Shahini – Faleminderit, për pyetjet!

Unë vij me shumë dëshirë në këtë komision. Përgjigjet e mia janë absolutisht ezauruese. Unë i kthej të gjitha përgjigjet e pyetjeve, edhe të atyre që bëtë tani, por edhe të atyre që keni bërë në seancë plenare. Pra, korrektësia ka qenë gjithmonë në nivel dhe jam shumë krenare për këtë gjë, sepse ekipi është gjithmonë në dispozicionin tuaj kur vijmë këtu.

Unë kam studiuar për qeverisje dhe kam master në “Politika publike”, dhe për një qeverisje të mire, duhet të shfrytëzohen resurset ekzistuese, si ato njerëzore dhe ato financiare, në mënyrë që të përfitojmë sa më shumë nga ata. Këtë gjë ne, si Ministri e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e kemi arritur ndër vite dhe e kemi përmirësuar edhe këtë vit.

Po filloj me pyetjen për infrastrukturën e shkollave. Natyrisht që në Tiranë ka ende shkolla me dy turne dhe në zona rurale ka klasa, ku numri i nxënësve po zvogëlohet. Lëvizjet demografike në Republikën e Shqipërisë dhe në të gjithë Europën Juglindore do të vijnë në këtë formë, siç kanë filluar në këto 20 vjetët e fundit dhe ne nuk kemi se çfarë të bëjmë tjetër, përveçse t’i përgjigjemi me politika.

Përgjigjja është kjo: në Bashkinë e Tiranës është projekti i 17 shkollave që ka filluar të zbatohet përpara disa viteve dhe do të mbyllet pas 3 vjetëve, i cili do ta zgjidhë problemin me dy turne, sepse në Tiranë kemi numrin më të madh të shkollave me dy turne.

Për sa u përket klasave kolektive, e ktheva përgjigjen edhe më herët, po e përsëris edhe një herë, aty ku është e mundur do të transferojmë nxënësit në shkollat më të afërta, në mënyrë që të marrin një arsim cilësor dhe aty ku nuk është e mundur, do të pajisim mësuesit me gjithë informacionin e nevojshëm, që të përmirësojnë punën në shkollë.

Unë pajtohem në teori me propozimin se duhet të ketë një trajnim të posaçëm që në fakultet për mësuesit e klasave kolektive, që në praktikë nuk funksionon shumë mirë, sepse duhet të marrim parasysh se klasat kolektive janë nëpër shkollat rurale, ku mësuesi është i zonës dhe në shumicën e rasteve nuk është e mundur që të çohet dikush tjetër në ato zona.

Vitet e fundit janë rikonstruktuar rreth 276 shkolla dhe 70 projekte te tjera, që kanë përfunduar me fillimin e shtatorit ose janë në përfundim e sipër. Me të njëjtin ritëm do të vazhdojmë rikonstruksionin e shkollave të tjera, që do të na vijnë si projekte.

Rikonstruksioni bëhet nga bashkitë, pra ato menaxhojnë buxhetin; ne thjesht e ndajmë si buxhet dhe kemi një kontribut nga bashkitë. Listën e shkollave që janë rikonstruktuar vitet e fundit, të ndara sipas bashkive, e kam dërguar një herë te grupi parlamentar, por do ta dërgoj edhe një herë tek të gjithë deputetët. Ekziston edhe lista e shkollave sipas amortizimit që është bërë vjet dhe është mbyllur si proces, ku i kemi inventarizuar të gjitha shkollat. Me vendimet që kemi marrë për ndërhyrje në shkolla, me buxhetin e vitit 2019, janë mbyllur shkollat që kanë pasur rrezikshmëri më të madhe, të cilat kanë pasur dëmtime të ndryshme. Sot nuk i kemi më ato problematika dhe tani jemi fokusuar te shkollat që janë më të amortizuara, por jo të rrezikshme për të vazhduar mësimin. Prandaj kemi bërë progres në këtë drejtim me buxhetin që kemi në dispozicion.

Ju ftoj të gjithëve, që të njëjtin pasion dhe të njëjtin intensitet ta aplikoni edhe kur të diskutojmë buxhetin, në mënyrë që të kemi sa më shumë nga pjesa e tortës që i takon arsimit dhe ta shfrytëzojmë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Vlerësuesit e cilësisë së arsimit, nuk do të quhen më inspektorë, sepse inspektori shikon se çfarë ndodh në terren dhe ndëshkon, ndërsa vlerësuesi shikon se çfarë po ndodh në terren dhe jep këshilla për të përmirësuar gjendjen. Jemi të vetëdijshëm që paga e tyre nuk është e madhe, por ajo është miratuar nga Drejtoria e Administratës Publike, edhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe ne do të punojmë me këto paga në këtë fazë. Ne po bëjmë betejë të vazhdueshme për rritjen e pagave të ky grup punonjësish, që është shumë i rëndësishëm për sistemin tonë arsimor.

Për laboratorët, të gjitha shkollat që janë rindërtuar kohët e fundit janë të pajisura me të gjithë laboratorët e shkencave, të teknologjisë informative dhe me biblioteka, ku nxënësit mund të ulen e të mësojnë, dhe të përdorin edhe librat që janë në dispozicion.

Ndërhyrjet e reja, siç e përmendi edhe deputeti, që janë bërë nëpër shkolla, kanë sjellë përmirësim cilësor të strukturave shkollore. Nxënësit, mësuesit dhe prindërit janë shumë më të lumtur sase kanë qenë më përpara. Gjithsesi, laboratorët shtohen kudo që kemi ndërhyrë me investime të reja nëpër shkolla.

Për sa u përket mësuesve ndihmës, është një diskutim që ndodh vazhdimisht, jo vetëm për mësuesin ndihmës, por edhe për mësuesin e zakonshëm. Nëse mësuesja ka nevojë të marrë tre muaj pushim, prindërit ankohen përse po u ndërrohet mësuesja nga klasa e parë deri në klasën e pestë. Praktika në të gjitha vendet e zhvilluara është që një mësues nuk qëndron me të

njëtin grup nxënësish nga klasa e parë deri në të pestën, pra nuk i bëhet prind i dytë, sepse mësuesi ka një tjetër rol.

Për sa i përket rastit konkret, nuk e di, sepse duhet të marrim më tepër informacion, por një gjë që ka ndodhur e kemi rregulluar këtë vit. Për një periudhë të ndërmjetme kemi pasur mësues ndihmës me kontrata të përkohshme; ata kanë qenë psikologë dhe kanë luajtur rolin e mësuesit ndihmës. Këtë gjë nuk mund ta vazhdojmë më, sepse mësuesi ndihmës është mësues dhe ndihmon nxënësin me aftësi të kufizuara që të arrijë potencialin e tij akademik, dhe nuk merret me gjendjen e tij psikosociale, sepse është një person tjetër i dedikuar që e bën atë punë. Prandaj në disa raste kemi qenë të detyruar, ku kemi pasur psikologë me kontrata të përkohshme, t'i zëvendësojmë me mësues dhe ta vendosim të gjithë sistemin në funksion dhe në shërbim të nxënësve.

Çdo rast individual që ju referohet, ju lutem ma referoni mua dhe ne me shumë dëshirë i takojmë prindërit, flasim me ta dhe ua shpjegojmë. Vendosja e mësuesit ndihmës nëpër shkolla ka qenë shumë emancipuese dhe gjatë këtyre katër vjetëve, që mësuesi ndihmës është nëpër shkolla, është rritur shumë numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që vijnë në shkollë. Prindërit kanë filluar ta kuptojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk duhet të mbyllen në shtëpi, por duhet të çohen në shkollë për të marrë arsimim të barabartë me nxënësit e tjerë. Prandaj të vijojmë ta bëjmë më shumë ngritjen e vetëdijes për këtë projekt. Nëse është e nevojshme, mund të kontaktojmë me secilin prind individualisht. Unë kam të gjithë dëshirën dhe vullnetin për ta bërë këtë gjë. Nuk e di nëse lashë ndonjë pyetje pa u përgjigjur?

Fatjona Dhimitri – A kanë mbetur pyetje të tjera pa u përgjigjur?

Kishe ndonjë gjë, Milva?

Milva Ekonomi – Unë nuk kisha ndonjë gjë, por dua të falënderoj ministren për gatishmërinë e saj për të ardhur dhe për të na shpjeguar se si nisi ky vit shkollor. Ne do të kemi dëgjesa të tjera, sepse buxheti po afron dhe ai lidhet me shumë aktivitete që ju do të kryeni në ministri. Gjithashtu, ka qenë shumë e rëndësishme të shikojmë gatishmërinë që patët në një moment psikoemocional të fëmijëve, duke i ndihmuar që të rrinë afër prindërve dhe duke shpjeguar se çfarë është tërmeti nga pikëpamja shkencore, në mënyrë që të mos lëndoheshin më shumë emocionalisht.

Unë dua të shtoj, lidhur me informacionin që duhet të kemi parasysh në fillimvit, se ne deputetët, kur u ndamë në zonat e tërmetit, një nga gjërat që patëm si detyrë ishte të shikonim nëse kishte shkolla të dëmtuara dhe t'ju referonim ministrisë, përveç familjeve. Fatmirësisht në Durrës nuk pati shkolla të dëmtuara, por nuk e di nëse në zona të tjera të Tiranës apo të

Elbasanit pati shkolla të dëmtuara, por mbase kjo do të ishte një nga gjërat që duhet të ketë vëmendjen kryesore në listën e investimeve prioritare që duhet të kryeni këtë vit.

Unë mendoj se ashtu siç ka qenë deri tani, i gjithë diskutimi ynë me ministren lidhur me nevojën që kemi për t'u sqaruar për çështje të ndryshme të arsimit, do të vazhdojë komunikimi, duke ju ftuar në seanca dëgjimore. Prandaj faleminderit shumë për gatishmërinë!

Fatjona Dhimitri – A ka pyetje të tjera?

Po, urdhëroni.

Kostaq Papa – Përsëritet, unë e pashë me shumë kujdes materialin dhe mund të them se është një material i pranueshëm, sepse problematikat në lidhje me shkollat janë në vazhdimësi dhe në zhvillim. Por dua t'i kujtoj ministres disa problematika që dalin gjatë procesit. Për shembull, për të përmirësuar moszvogëlimin e nxënësve në shkolla, do të ishte më mirë një bashkëpunim mes pushtetit lokal, bashkive dhe ministrisë për të zvogëluar, pavarësisht se kemi një lirim të lëvizjes së nxënësve në shkollën që ata duan, për një grupim të shkollave në lidhje me njësitë administrative. Pra, fëmijët e fshatit të mos shkojnë në shkollën më të afërt të qytetit, por të shkojnë në shkollën e njësisë administrative ku ata jetojnë. Sigurisht që ne e lejojmë lëvizjen e lirë të nxënësve, por për efekt mosgrupimi të shumë nxënësve nëpër qytete, t'u japim mundësi që edhe shkollat bazë apo në qendër të njësive administrative të jenë efektive.

Gjithashtu, duhet të ishte e garantuar dhe e rregulluar në mënyrë të përhershme që lëvizja paralele duhet t'i paraprijë gjithmonë portalit “Mësues për Shqipërinë”, sepse si fillim duhet të rregullohen arsimtarët që janë në gjendje pune, pastaj rifusim në sistem arsimtarë të rinj. Kjo nuk ndodh gjithmonë, sepse ka problematika. Unë, si një njohës i mirë i terrenit, në disa rrethe shikoj se ka problematika të tilla, por kjo nuk ndodh nga ministria, sepse udhëzimet janë të rregullta, por procedurat po shkelen në bazë.

Ajo që duhet të rishikojë tjetër ministria, e theksuan edhe kolegët, ka të bëjë me përmirësimin e kuotave të transportit. Shqipëria bën pjesë në ato vende, ku rrethet kanë shumë pak rrugë të asfaltuara dhe të përmirësuara. Edhe mbas 20 vjetësh do të bëjmë kërkesë për përmirësim të kuotës së transportit, sepse Shqipëria bën pjesë në vendet me më pak rrugë të përmirësuara në zona dhe njësi administrative.

Funksionimi i inspektorëve, me këtë ndërtim të ri të drejtorive rajonale, duhet bërë sa më shpejt. Ndoshta nuk po e them emërtesën siç e thatë ju, por është e domosdoshme të përshpejtohet, për arsye të funksionimit më të mirë të shkollës, kërkesave ndaj mësuesve dhe cilësisë së shkollës.

Ajo çfarë shikoj në mënyrën e procesit të konkurrimit të arsimtarëve, ka të bëjë me konkurrimet brenda profileve të mësuesisë, por jo një mësues të konkurrojë në profile të ndryshme. Çfarë ndodhi në një shkollë? Një mësues i ciklit të ulët konkurroi me një mësues matematike për vendin e punës në shkollë të mesme dhe fitoi mësuesi i ciklit të ulët. Kjo është anormale, sepse ky mësues do të jepte mësim në gjimnaz. Kjo është e papranueshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kanë ndodhur dhe është anuluar, sepse nuk mund të ndodhë. Pra, duhen parë këto gjëra konkrete, sepse kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë së punës.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni!

Lindita Nikolla – Edhe unë falënderoj ministren jo thjesht për raportimin që bëri, patjetër që ka vlerën e vet, por më tepër për punën e palodhur që ka bërë gjatë kësaj periudhe që është në krye të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Ky nuk është një kompliment i rastit që duhet bërë, por në vetëdijen time më shumë, të dashur kolegë, më lejoni t’ju them një informacion: ministrja sot raportoi se si 5 sistemet e reja, që funksionojnë në sistemin e arsimit parauniversitar këtë vit, falë punës dhe përkushtimit të saj në krye të Ministrisë së Arsimit, janë përmirësuar. Sistemi kurikular në të gjithë sistemin e arsimit parauniversitar, u tha dhe nuk do ta përsëris, por dua ta sjell në vëmendjen tuaj, është një sistem i ri në qasje, në tekste, në ndërveprime dhe në mësimdhënie. Pra, ka një përmirësim jo vetëm në futjen e kurikulës së klasës së pestë, u tha edhe nga ministrja, edhe nga drejtori, por edhe për çdo fëmijë nga 3 deri në 18 vjeç.

Kemi një përmirësim të sistemit të ri për punësimin e mësuesve. Pra, portali “Mësues për Shqipërinë” këtë vit është përsosur. Mësuesit kanë të drejtë jo ta refuzojnë tre herë, por pafundësisht, deri sa ata ta ndiejnë të nevojshëm se ku duhet të punojnë. Marrin vlerësimin për të filluar punën në shkollë në mënyrë automatike, gjë që rrit transparencën dhe kjo është bërë më mirë se 1 vit më parë.

Kemi përmirësime në sistemin e administrimit. Kemi një sistem të ri të administrimit të arsimit, ku duhet thënë se rikthehet vlerësuesi apo inspektuesi në shkolla. Pra, kishim një sistem kokëposhtë të vlerësimit të arsimit.

Po ashtu, kemi përmirësim nga një vit më parë edhe në sistemin e drejtimit të shkollës, në atë që lidhet me shkollën e drejtorëve.

Unë, si deputete, e inkurajoj ministren e Arsimit duke i thënë: mos u frikëso nga pyetjet që përsëriten e përsëritën, sepse do të japësh përgjigje, por përsëri ato nuk do të kuptohen.

Dua të sjell në vëmendje se ky është një vit që orari 3 në 6 ka fituar qytetarinë. Kujtoj këtu 1 vit më përpara se çfarë gjyqesh u bënë, sepse do të bëhej një dëm i tmerrshëm nëpër shkolla nëse orari 3 lëndë në 6 orë do të futej në të gjithë sistemin. Ne patëm guximin dhe falë mësuesve sot është kthyer në mënyrë jetese në shkollë dhe janë prindërit e nxënësit ata që e kërkojnë vazhdimisht.

Po ashtu, kemi një vit të ri shkollor ku bërja e detyrave të shtëpisë jo vetëm që do të vijojë, por do të shtohet edhe në shkollat e reja, e cila do të jetë një mënyrë e re për të mundësuar ata mësues që dalin nga sistemi të jenë pjesë e sistemit, duke u futur në projektin “Bëjmë detyrat e shtëpisë në shkollë”.

Gjithashtu, duhet t’ju informoj se klasat kolektive nuk janë një dukuri e re për Shqipërinë, por janë një dukuri që e ka shoqëruar sistemin arsimor në të gjitha vitet, edhe ato të diktaturës. Është një dukuri që ndodh në Francë, në Spanjë, në Portugali dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pra edhe në vende të tjera. Ajo që po ndodh ndryshe nga vitet më përpara është se po flitet për klasat kolektive. Deri një vit më përpara nuk ka guxuar kush t’i adresojë klasat kolektive dhe jo më të adresojë procesin e tyre.

Zonja kryetare, nuk janë mbyllur shkolla, por klasa kolektive. Janë mbi 300 vitin që shkoi dhe të tjera këtë vit, duke u mundësuar atyre fëmijëve të shkollohen në klasa normale.

Është punuar më mirë se një vit më parë edhe në sistemin e ri të kualifikimit, për të cilën foli Gerti dhe nuk dua të zgjatem, përveçse t’ju përgëzoj dhe t’ju them vazhdoni me këtë ritëm. Çdo gjë që është nisur në sistemin arsimor do të vazhdojë të japë produktet pak e nga pak, kjo falë përkushtimit në vijim dhe qenies suaj në krye të Ministrisë së Arsimit.

Përgëzime dhe suksese!

Fatjona Dhimitri – A ka pyetje të tjera? Meqenëse nuk ka pyetje dhe diskutime të tjera, kuptohet që do të kemi seanca të tjera takimi bashkë, ju them mirupafshim.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA